



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:042704
Datë: 19.11.2018
Numri i dokumentit: 00171632

P.nr. 1203/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.S., për shkak të veprës penale Vjedhja, nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr. 1811/2016, të datës 07.10.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 15.11.2018, mori dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa, më dt. 19.11.2018, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A.S., nga babai M. dhe nëna H., i lindur më datë ... në Gjilan, ku edhe jeton, në rr. “ ... ” nr. ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, më datë 16 /18.08.2016, në kohë të papërcaktuar në Gjilan në rr. “Xhon Sereqi”, afër Kombinatit të Duhanit, me qëllim të përfitimit të kundërligjeshëm pasuror për vete, ka kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarit F.R., në atë mënyrë që nga kamioni “VW”, ngjyrë portokalli, me tabela ..., ka marrë baterinë 75 amper dhe e ka shitur për 10 € në depot për grumbullimin e metaleve, me çka të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar,

-me çka kë kryer veprën penale, **Vjedhja**, nga **neni 325 par. 1 të KPRK-së**, andaj, Gjykata, në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 51, 73, 114 të KPRK-së dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i shqipton:

D Ë N I M M E K U S H T

Të akuzuarit A.S., me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajsh** dhe **Dënim Gjobe**, në shumën prej **150 (njëqindpesëdhjetë) €**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1 (një) viti**, nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Obligohet i akuzuari që të paguaj **paushallin gjyqësor** në shumë prej **15 (pesëmbëdhjetë) €**, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzën PP.II.nr. 1811/2016, të datës 07.10.2016, kundër të akuzuarit A.S., për shkak të veprës penale, Vjedhja, nga neni 325 par. 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjtin tai shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit A.S., erdhi në përfundim se i akuzuari e ka kryer veprën penale Vjedhje, nga neni 325 par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar vullnetarisht, pa presion fajësinë, pas njoftimit nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, pati sjellje të mira në Gjykatë, pendimi i tij, si dhe premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, ndërsa si rrethanë rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 par. 4 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 1203/2016, më datë 19.11.2018**

**Gjykatësja e vetme gjyqësore,
Luljete Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:042704
Datë: 19.11.2018
Numri i dokumentit: 00171632